VENDIM
Nr.1204, datë 11.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.659, DATË 3.10.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE " PËR RREGULLAT E KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ME MJETE ELEKTRONIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

V ENDOSI:

Në fjalinë e parë të pikës 19 të kreut IV " Dispozita të fundit", në rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit me mjete elektronike, të miratuara me vendimin nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave, emërtimi "...Agjencia e Prokurimit Publik..." zëvendësohet me "...Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha